

VENDIM
Nr.806, datë 16.11.2011

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.53, DATË 21.1.2009 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR NGARKIMIN E MINISTRISË SË BRENDSHME PËR KRYERJEN E PROCEDURAVE
TË PROKURIMIT PUBLIK, NË EMËR DHE PËR LLOGARI TË KRYEMINISTRISË,
MINISTRIVE DHE INSTITUCIONEVE TË VARËSISË, PËR DISA MALLRA DHE
SHËRBIME”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 11 pika 3 e 75 të ligjit nr.9643, datë 21.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në fund të pikës 1 të vendimit nr.53, datë 21.1.2009 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Përfshirja për vitin 2011, lejohet Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) të realizojë vetë procedurat e prokurimit për blerjen e pajisjeve elektronike e të materialeve për zyra, për investime për rikonstruksionin e zyrave të sporteleve, të sistemit elektronik të integruar, të materialeve promovuese dhe të logos. Procedurat e prokurimit, përfshirë lidhjen e kontratave përkatëse dhe botimin e njoftimit të kontratës së nënshkruar në Buletin e Njoftimeve Publike, të përfundojnë brenda datës 10.12.2011.”.

2. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Agjencia e Prokurimit Publik dhe Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha